



## LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM



<b>PJESA 2:</b>	RREZIQET NË PUNË
<b>Tema 2.6.</b>	RREZIQET QË LIDHEN ME AKSIDENTET NË PUNË
<b>Nën-tema 2.6.4.</b>	<b>PUNA NË LARTËSI</b>
<b>Ligji / rregulloret përkatëse:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë;</li><li>• Rregullore (MPMS) Nr.01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (MPMS) Nr.04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës;</li><li>• Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë;</li><li>• Rregullore (MPMS) Nr.06/2017 për kriteret minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendndërtimet të përkohshme apo mobile.</li></ul>
<b>Shkurtesa:</b>	• MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>Fushëveprimi i listës kontrolluese:</b>	Kjo listë kontrolluese është e zbatueshme në të gjitha industritë dhe sektorët nën fushëveprimin e zbatimit të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe bazat mbi të cilat kryhen puna ose trajnimi në vendet e punës ku punohet në lartësi.
<b>Përdorimi i listës kontrolluese:</b>	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	<b>INSPEKTIMI I RREZIQEVE NË VENDET E PUNËS ME PUNË NË LARTËSI – RASTE TË SHPESHTA</b>			
	<ul style="list-style-type: none"><li>* <i>Bëhuni shembull; respektoni rregulloret e sigurisë dhe shëndetit në lokacionin / vendet e punës të inspektuara!</i></li><li>* <i>Gjatë vizitës në lokacion/vendin e punës kushtoni vëmendje aspekteve të përgjithshme ose organizimit të punës dhe proceseve, duke përfshirë mjedisin rrethues dhe faktorët që mund të kenë efekt mbi punëtorët ose publikun e përgjithshëm.</i></li><li>* <i>Merrni shënime për vendet e punës/pajisjet e vëzhguara dhe bëni fotografi të rrethinës (kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë).</i></li><li>* <i>Mbani mend: pyesni disa prej të punësuarve në lidhje me informacionin e tyre në lidhje me rreziqet dhe masat parandaluese gjatë punës në lartësi</i></li></ul>			

	<p>* Nëse keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspertin tuaj për SSHP, takohuni me të/ata.</p> <p>* Ftoni përfaqësuesin e të punësuarve të marrë pjesë në kontrollimin e dokumenteve.</p>			
1.	<p><b>A është kryer vlerësimi i riskut për punën në lartësi?</b></p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Është obligim i juaji të siguroni vlerësimin e riskut - kontrolloni nëse është kryer dhe dokumentuar.</li> <li>● Kontrolloni nëse janë vlerësuar aspektet e organizimit të punës për të shmangur punën në lartësi (p.sh., përdorimi i një organizimi ose teknologjie tjetër të punës që nuk kërkon punë në lartësi).</li> <li>● Kontrolloni nëse vlerësimi i riskut përmban analiza të rreziqeve që lidhen posaçërisht me punën në lartësi, duke përfshirë të gjitha detyrat e punës të nevojshme për të siguruar punën në lartësi (p.sh., përgatitja e zonës, vendosja e pajisjeve, puna në lartësi, furnizimi i materialit dhe largimi i mbeturinave etj.).</li> <li>● Kontrolloni nëse janë marrë masat e nevojshme për t'i shmangur ose zvogëluar këto risqe (p.sh. masat e marra organizative ose teknike).</li> <li>● Kontrolloni nëse janë vlerësuar posaçërisht risqet për punë mbi 1.5 m dhe mbi 5 m.</li> </ul>			
2.	<p><b>A është siguruar që puna në lartësi të jetë e sigurt në çdo lokacion të punës?</b></p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 16 Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Kontrolloni nëse është siguruar që rëniet nga lartësia janë parandaluar fizikisht nga masat më të përshtatshme organizative dhe teknike (p.sh. platforma solide, skele të përshtatshme, dërrasa fundore të qëndrueshme, parrakë etj.).</li> <li>● Kontrolloni nëse është siguruar që të ofrohen dhe përdoren vetëm pajisjet ose mjetet e përshtatshme të mbrojtjes kolektive.</li> </ul>			

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse përdorimi i pajisjeve të lartpërmendura nuk është i mundshëm, kontrolloni nëse është siguruar që të ofrohen mjete të përshtatshme të qasjes, p.sh. (sistemet e ankorimit, rripat e sigurisë etj.).</li> </ul>			
3.	<p><b>A është ofruar informacion dhe trajnim i mjaftueshëm për të punësuarit në lidhje me rreziqet e punës në lartësi dhe masat e mundshme parandaluese?</b></p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Nenet 7, 9, 13, 20 Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV, V</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• A ka informacion (të shkruar) në dispozicion dhe të ofruar për të punësuarit (p.sh. materiale, trajnimi, broshura/postera)?</li> <li>• Kontrolloni nëse informacioni specifik për trajnim (nëse aplikohet) përfshin: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ rreziqet specifike për punën në lartësi, kërkesat për qasje në platformat e punës, kulme, skele etj., procedurat e emergjencës dhe shpëtimit, metodat e komunikimit me operatorët e makinerive etj.</li> </ul> </li> <li>• Kontrolloni nëse është ofruar trajnim formal për të punësuarit, përfshirë trajnimin specifik për punën në lartësi dhe përdorimin e pajisjeve të sigurisë?</li> <li>• A është përsëritur periodikisht sipas kërkesave ligjore dhe/ose në rastet kur kanë ndryshuar vendet e punës, pajisjet ose procedurat?</li> </ul>			
4.	<p><b>A ka pasur konsultime me punësuarit (dhe përfaqësuesit e tyre) në lidhje me punën në lartësi?</b></p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 19</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• A kanë qenë të përfshirë të punësuarit (dhe/ose përfaqësuesit e tyre) në vlerësimin e riskut gjatë punës në lartësi dhe planifikimin e masave parandaluese (p.sh. politikat organizative, planifikimi i punës, trajnimet për të punësuarit, konsultimet etj.).</li> </ul>			
5.	<p><b>A janë vendosur dhe siguruar orare të rregullta për mirëmbajtjen e pajisjeve (p.sh. platformat, shkallët, skelet etj.) dhe pajisjeve të sigurisë (p.sh. ankorimet, rripat etj.)?</b></p>			

	<p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 5 Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <i>Obligimi juaj është të siguroni kushte të sigurta dhe të shëndetshme të punës në të gjitha aspektet e punës.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse oraret e mirëmbajtjes mbulojnë kontrollet teknike të rregullta dhe në kohë për të gjitha platformat, shkallët, skelet dhe pajisjet e sigurisë sipas planeve të prodhuesit (p.sh. kontrolloni për defekte, pastrim etj.).</i> <i>Kontrolloni nëse ato sigurohen:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>para vënies në shërbim (fillimi i punës);</i></li> <li>○ <i>periodikisht (jo më pak se çdo 7 ditë);</i></li> <li>○ <i>menjëherë pas çdo modifikimi, periudhe të mospërdorimit, kohe me mot të ligë ose tërmeti, ose ndonjë ngjarjeje tjetër që rrezikon stabilitetin.</i></li> </ul> </li> <li>● <i>Kontrolloni nëse shënimet e nënshkruara të mirëmbajtjes mbahen dhe aneksohen si pjesë e dokumentacionit të ndërtimit.</i></li> </ul>			
6.	<p><b>A është siguruar që çdo vend pune në zonën ku kryhet puna në lartësi të jetë i sigurt, përfshirë edhe nga objektet që bien?</b></p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 5 Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca II</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <i>Kontrolloni nëse është vlerësuar mundësia për ta mbyllur ndonjë zonë të punës që kryhet nën zonën e punës në lartësi (p.sh., nën rampa ose skele).</i></li> <li>● <i>Nëse kjo nuk është e mundur, kontrolloni nëse janë siguruar struktura mbrojtëse të qëndrueshme për të mbrojtur nga puna që bëhet më lart, duke përfshirë rrugët e kalimit, si dhe nëse sigurohet mbrojtje nga rënia e materialeve (p.sh., rrjeta, mbulesa sigurie etj.).</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse janë siguruar parmakë fiks me shufër të dyfishtë (të paktën 0.9 m të lartë) për zonën e punës në lartësi (për punë me periudha të shkurtra (më pak se një ndërrim) që përfshin vetëm mjete të thjeshta, mjaftojnë parmakë me një shufër (të paktën 0.9 m të lartë) ose litarë.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse në zona të rrezikshme (zona e sigurt nga 3 m në 10 m për punime në lartësi prej 1.5 m; zona e sigurt nga 10 m në 20 m për punime në</i></li> </ul>			

	<p><i>lartësi prej 2 m; zona e sigurt nga 20 m në 30 m për punime në lartësi prej 2.5 m) është shënuar qartë një e dhjeta e lartësisë së strukturave për punimet mbi 30m.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <i>Kontrolloni nëse këto zona janë rritur me të paktën 1 m, nëse përdoren pajisje ngritëse.</i></li> <li>● <i>Në rastet kur vendkalimet për këmbësorë janë vendosur në rrugë ose janë shumë të ngushta, kontrolloni nëse janë siguruar parmakë me shufër të dyfishtë (të paktën 1.5 m të lartë) dhe mbulesa të përshtatshme kundër ujit dhe baltës, dhe që nuk ka zona me lartësi të ndryshme në rrugët e kalimit.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse në zonat ku kryhet puna në lartësi dhe ku objektet mund të bien nga lartësia, vendosen shenja të përshtatshme të sigurisë (p.sh., “Ngarkesa mbi kokë”) dhe ndalohet hyrja në zona të kufizuara me shenja të përshtatshme (p.sh. “ Ndalohet hyrja për persona të paautorizuar”).</i></li> </ul> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="text-align: center;">  <p>“Ngarkesa mbi kokë”</p> </div> <div style="text-align: center;">  <p>“Ndalohet hyrja për persona të paautorizuar”</p> </div> </div> <p><i>Kontrolloni nëse e keni caktuar personin përgjegjës për mbikëqyrjen e respektimit të këtyre kërkesave.</i></p>			
7.	<p><b>A janë marrë masa që rënia e materialeve nga vendet e punës në lartësi të jetë e sigurt?</b></p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 5 Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <i>Kontrolloni nëse është analizuar nevoja për të hedhur ndonjë objekt nga vendet e punës nga lartësia, dhe pranohet vetëm në situata të jashtëzakonshme dhe lejohet vetëm nëse materialet dhe vendi i ndikimit janë të lidhura fort,:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>është siguruar kundër hyrjes së personave të paautorizuar;</i></li> <li>○ <i>mbrohet nga kthimi ose stërpikja aksidentale e materialeve të rëna.</i></li> </ul> </li> </ul>			

	<ul style="list-style-type: none"> <li>● <i>Kontrolloni nëse është siguruar që të mos hidhen materiale, nëse nuk është e mundur të parashikohet vendi i ndikimit (p.sh. fletët metalike, dërrasat etj.).</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse janë siguruar masat nëse materialet e hedhura lëshojnë pluhur ose ndonjë efekt tjetër të padëshirueshëm.</i></li> </ul>			
8.	<p><b>A është siguruar që ruajtja e materialeve dhe pajisjeve në zonat e punës në lartësi të jetë e sigurt?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca V</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <i>Kontrolloni nëse shpërndarja e ngarkesës (materialeve/pajisjeve) në të gjitha llojet e skeleve ose platformave, është sa më e ekuilibruar, dhe nëse caktohen dhe respektohen kufijtë maksimalë të lejuar të ngarkesës.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse lëvizja ose vendosja e ngarkesave kryhen në mënyrë të sigurt për të shmangur lëkundjen/lëvizjen e skeleve, kontrolloni nëse punëtorët janë të trajnuar.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse në skele ose platforma ka mbetur ndonjë material i panevojshëm.</i></li> </ul>			
9.	<p><b>A ka ndriçim të mjaftueshëm në zonat e punës në vendet e punës në lartësi?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) 01/2020, Tabela 2&amp;3</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <i>Kontrolloni nëse të gjitha zonat e punës kanë nivele të mjaftueshme të ndriçimit (qoftë natyral dhe/ose artificial) dhe sistemet e ndriçimit mbahen në rregull (p.sh., pa llamba të prishura, pa kablllo të lirshme ose të dëmtuara etj.)</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse ka sistem ndriçimi emergjent (rezervë) dhe nëse është testuar dhe mirëmbajtur.</i></li> </ul>			
<b>MBIKËQYRJA E LOKACIONIT / VENDIT TË PUNËS</b>				
<b>Zgjidhni vetëm llojin e duhur të punës në lartësi për inspektimin tuaj</b>				
10.	<p><b>A është siguruar që puna në parapet dhe pranë hapjeve të kateve të jetë e sigurt për punëtorët?</b></p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 5</p>			

	<p>Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <i>Kontrolloni nëse të gjitha zonat ku ekziston mundësia për rënie nga më shumë se 2 m (p.sh., qoshet, anët e ndërtesave, shahtat dhe hapjet e kateve, korridoret e kalimit ajror, shkallët etj.) janë të pajisura me parmakë mbrojtës (lartësia minimale prej 90 cm) që i mbrojnë punëtorët dhe/ose materialet nga rënia:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>parmakët mbrojtës mund të jenë në formë perde për ta mbuluar të gjithë zonën;</i></li> <li>○ <i>për parmakë të ndarë duhet të ketë të paktën 1 shufër të mesme (jo më shumë se 50 cm nga dyshemeja dhe shufra e sipërme).</i></li> </ul> </li> <li>● <i>Kontrolloni nëse parmakët janë bërë nga materiale të qëndrueshme dhe mirëmbahen (p.sh., pa defekte të dukshme, të pastra etj.).</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse ngritja, modifikimi ose shkëputja e parmakëve kryhet nga punëtorë të trajnuar nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të menaxherit të vendit të punës dhe me materiale të kontrolluara nga menaxheri i vendit të punës.</i></li> </ul>			
11.	<p><b>A është siguruar që puna në kulme mund të kryhet në mënyrë të sigurt?</b></p> <p>Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, Neni 5  Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV  Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca II</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <i>Kontrolloni nëse është siguruar që në kulme janë vendosur numri i mjaftueshëm i shkallëve dhe dërrasave të qëndrueshme.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse janë siguruar pengesa ose platforma të përshtatshme për të parandaluar rënien e personave prej kulmeve, veçanërisht për kulmet metalike.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse është kontrolluar nëse kulmi (ose qasja në kulm) ka zona të bëra nga materiale të brishta ku mund të ndodhë depërtimi, dhe nëse ato janë të siguruara ose qasja në këto zona është e kufizuar.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse është siguruar që nëse nuk janë të mundshme masat e mbrojtjes kolektive, sigurohen dhe përdoren sisteme individuale të sigurisë (p.sh. rripat e sigurisë etj.) dhe vendosen shenja të përshtatshme të sigurisë (p.sh. Duhet të mbahen rripat e sigurisë”).</i></li> </ul>			



*Duhet të mbahen rripat e sigurisë.*

12. **A është siguruar që puna në platforma të mund të kryhet në mënyrë të sigurt?**

Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca IV, V

- *Kontrolloni nëse është siguruar që platformat me lartësi prej të paktën 2 metrash të bëhen nga dërrasa të qëndrueshme ose fletë metalike, të cilat nuk lëvizin dhe nuk kanë më shumë se 3 cm distancë midis dërrasave ose fletëve.*
- *Kontrolloni nëse dërrasat/fletët metalike janë të fiksuara mirë me njëra-tjetrën dhe me shtyllat dhe traversat e platformës dhe e mbulojnë plotësisht distancën midis shtyllave.*
- *Kontrolloni nëse platforma ka parrmakë me dy shufra (me distancë prej jo më shumë se 45 cm).*
- *Kontrolloni nëse platforma ka një fund të qëndrueshëm prej të paktën 10 cm në lartësi.*
- *Kontrolloni nëse platforma është të paktën 80 cm e gjerë.*
- *Kontrolloni nëse platforma nuk është më shumë se 60 cm jashtë nga fundi i murit, nëse puna kryhet në fund të murit ose në kënd.*
- *Kontrolloni nëse distanca midis strukturës dhe platformës nuk është më e madhe se 25 cm.*

13. **A është siguruar që puna në shkallët e lëvizshme të mund të kryhet në mënyrë të sigurt?**

Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca V

- *Kontrolloni nëse shkallët e lëvizshme të përdorura në vendin e punës janë bërë nga materiale të qëndrueshme dhe stabile dhe mirëmbahen siç duhet (p.sh., të pastra, jo të dëmtuara ose të përkulura, jo të lyera etj.):*



	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ për shkallët prej druri, shkallët duhet të fiksohen mirë dhe të kapen në vrima në shtylla;</li> <li>○ distanca midis shkallëve nuk duhet të kalojë 30 cm;</li> <li>○ shkallët me më shumë se 4 metra gjatësi duhet të bëhen vetëm prej metali.</li> <li>● Kontrolloni nëse shkallët e lëvizshme përdoren në mënyrë korrekte, vetëm në vendin e duhur dhe në përputhje me qëllimin e synuar: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ skaji i sipërm i shkallëve është i fiksuar në vendin ku mbështetet;</li> <li>○ nëse kjo nuk është e mundur, shkalla do të fiksohet në tokë;</li> <li>○ në rast se nuk është e mundur, një person tjetër i caktuar e ruan për të parandaluar rrëshqitjen e shkallëve;</li> <li>○ shkallët duhet të vendosen në sipërfaqe të fortë;</li> <li>○ nëse përdoret për qasje, fundi i shkallës shtrihet për të paktën 100 cm mbi mbështetjen e fundit.</li> </ul> </li> <li>● Kontrolloni nëse është siguruar që nuk përdoren shkallët e dëmtuara (p.sh. u mungojnë shkallë, me defekte të dukshme, etj.), kontrolloni nëse shkallët e disponueshme në vendin e punës kanë defekte.</li> </ul>			
14.	<p><b>A është siguruar që puna në skele të mund të kryhet në mënyrë të sigurt?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca V</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Kontrolloni nëse skelet për vendin e veçantë të punës janë dizajnuar, ndërtuar dhe mirëmbahen siç duhet.</li> <li>● Kontrolloni nëse janë ngritur nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të menaxherit të vendit të punës me kompetencë të mjaftueshme .</li> <li>● Kontrolloni nëse për skele përdoren vetëm materialet e kontrolluara nga menaxheri i vendit të punës (përfshirë rampat, kalimet dhe shkallët), p.sh., pjesët metalike duhet të jenë të forta dhe pa defekte ose shenja të dëmtimit, materialet prej druri duhet të jenë të qëndrueshme dhe pa lyerje.</li> <li>● Kontrolloni nëse shtyllat e skeleve janë sa më pingule dhe distanca ndërmjet tyre nuk i kalon 3 metra, ato vendosen në sipërfaqe të qëndrueshme jo të rrëshqitshme.</li> <li>● Kontrolloni nëse traversat dhe platformat lidhëse janë horizontale dhe janë fiksuar fort në shtylla ose mure.</li> </ul>			

	<ul style="list-style-type: none"> <li>● <i>Kontrolloni nëse shtyllat mbështetëse të skeleve janë të qëndrueshme dhe të forta, të vendosura në sipërfaqe të qëndrueshme, kontrolloni nëse përdoren materiale të papërshtatshme (p.sh., tulla, kafaze druri, kuti etj.).</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse pjesët e ndërtesave ose strukturat e tjera të përdorura si mbështetëse janë të forta dhe të qëndrueshme.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni që pjesët e ndara të skeleve të mos lihen pa mbikëqyrje dhe që të jetë e pamundur të përdoren, dhe se janë të shënuara me shenja të duhura paralajmëruese që ndalojnë përdorimin e këtyre elementeve dhe, nëse është e nevojshme, hyrja në këto pjesë bllokohet nga parrakët mbrojtës.</i></li> </ul>			
15.	<p><b>A është siguruar që puna në skelet e varura të mund të kryhet në mënyrë të sigurt?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca V</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <i>Kontrolloni nëse skelet e varura janë dizajnuar, ndërtuar dhe mirëmbahen si duhet, dhe përdoren vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>ato mund të fiksohen në mënyrë të sigurt;</i></li> <li>○ <i>pajisja ngritëse, litarët, zinxhirët, etj. që e mbajnë, duhet të mbahen të tensionuar (litari duhet të bëjë të paktën dy rrotullime në secilën rrotull dhe gjatësia e tij duhet të tregohet qartë), kjo pajisje duhet të jetë e pajisur me frena dhe mekanizma ndalimi.</i></li> </ul> </li> <li>● <i>Kontrolloni nëse dërrasat dhe materialet e përdorura janë mjaft të forta, të fiksuara dhe të mbështetura.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni, nëse përdoren kundërpeshat, që ato janë të fiksuara në mënyrë të sigurt në shtylla.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse nuk mund të vërehen pengesa për qasje dhe nëse është dizajnuar për të parandaluar rënien e mjeteve dhe pajisjeve.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse janë marrë masa për ta parandaluar (duke përfshirë shporta, ulëse ose kafaze) rrëzimin, përkuljen dhe lëkundjen.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni nëse përdoren vetëm tela çeliku ose litarë të standardizuar me kapacitet të shënuar të ngarkesës.</i></li> <li>● <i>Kontrolloni, nëse përdoren kafaze, shporta ose ulëse, që janë:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>të qëndrueshme, të bëra nga materiale të forta dhe në gjendje të mirë;</i></li> </ul> </li> </ul>			

	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ të vendosura, të mbështetura dhe lidhura në mënyrë të sigurt me një instalim tjetër;</li> <li>○ të paktën 0.9 m thellësi dhe përdoret nën mbikëqyrjen e menaxherit të vendit të punës.</li> </ul>			
16.	<p><b>A është siguruar që puna në skelet mobile të mund të kryhet në mënyrë të sigurt?</b></p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.06/2017, Shtojca V</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Kontrolloni nëse skelet mobile janë dizajnuar, ndërtuar dhe mirëmbahen siç duhet.</li> <li>● Kontrolloni nëse përdoren vetëm materiale të qëndrueshme dhe të forta për skelet mobile.</li> <li>● Kontrolloni nëse skelet mobile janë vendosur në skelet e palëvizshme.</li> <li>● Kontrolloni nëse skelet mobile në rrota ose shina janë ngritur në sipërfaqe të paqëndrueshme ose të pabarabartë, janë fiksuar në mënyrë të sigurt, janë siguruar nga lëvizjet e papritura dhe kanë shkallë të përshtatshme për qasje.</li> </ul>			